



Pranuar / Dorezuar Punijena / Prodato Received / Delivery	24.12.2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3305/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.366/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.366/2020 të datës 19.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], me adresë banimi Rr. " Hamëz Jashari" Nr.11. 5/9 , Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështje juridike "kontest nga marrëdhënia e punës-mosekzekutimi i vendimit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.366/2020 e datës 19.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. Shfuqizohet, Vendimi me Nr. 2/1K i datës 09.10.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.05.2012 në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën "Zyrtar i Arsimit të Mesëm të Ulët", me koeficient 7 (shtatë) të pagës, me datë 10.06.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me kërkesë që t'i ngritet koficienti i pagës nga shtatë (7) në koficientin tetë (8).

Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me vendimin Nr. 2/1K të datës 09.10.2020, ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar duke i njohur të drejtën e ngritjes së koeficientit të pagës nga 7 (shtatë) në 8 (tetë).

Pas mos zbatimit të këtij vendimi ankuesi me datën 19.11.2020, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me nr. Protokollit 2649/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa Këshilli me datë 10.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkesat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.366/2020 të datës 19.11.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës: Ankesën e datës 10.06.2020 të parashtruar në Komisionin e Ankesave dhe Parashtrësive: Përshkrimin e detyrave të punës: Vendimi i datës 09.10.2020 me numër 1814 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtrësive në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë: Shkrese drejtuar Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për zbatim të Vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave: Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2020: Përgjigja në ankesë e datës 10.12.2020 me numër të protokollit 3084/2020: Akt emërimi i datës 04.05.2012 i ankuesit [REDAKTUAR], Emali i datës 10.12.2020: Emali i datës 22.12.2020 i protokolluar me datë 23.12.2020 lidhur me kërkesat e ankuesit drejtuar në MASHT:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e pa bazuar, sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili kërkon nga Këshilli që ta vejë në zbatim Vendimin e datës 09.10.202, të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (me tej MASHT).

Pasi analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësive në Ministrinë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit Nr. 05/L-031 par Procedurën e Përgjithshme Administrativ, i cili përcakton se " 1. pos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës" si dhe nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se "Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të ankesës", në këtë kuptim, Kolegji ka gjetur se Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësive në Ministrinë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, vendimin Nr. 2/1K të datës 09.10.2020 e ka nxjerrë jashtë afatit ligjor duke aprovuar ankesën e ankuesit të parashtruar me datë 10.06.2020, andaj si rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas ka shqyrtuar shkresat të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita



në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.366/2020

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

